



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 104/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 4800 (katërmijetëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 24.01.2011, nga (BIRN), me te cilën pretendohet se më datë 22.01.2011 janë shpërndarë SMS telefonik nga numri 044 690 885 duke bërë thirrje për të votuar për Xhafer Tahirin, kandidat për deputet i LDK-së, e që sipas parashtruesit të ankesës që është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika (a) dhe (b).

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi, në të cilat shihet qartë dërgimi i SMS-ve për të votuar Xhafer Tahirin kandidat nga rradhët e subjektit politik LDK, në të cilin figuronte teksti “I nderuar Mitrovicas! Voto LDK 36 Beso ne rini Voto Mr. Sc Xhafer Tahiri Kryetar, Forumi Rinor LDK me nr 35 Vota juaj do te jete zeri i rinise ne Parlament! Parashtruesi i ankesës propozon qe të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik LDK, më datë 25.01.2011, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 26.01.2011, gjerë në ora 12:00.

PZAP-i, mori përgjigje në ankesë me datën 25.01.2011 nga subjekti politik LDK, në të cilën theksohet këta SMS janë dërguar pa dijen e kandidatit dhe nga numri telefonik i panjohur për të. Po ashtu, në përgjigje ky subjekt politik ka deklaruar se “nga ky fakt konsiderojmë se kjo provë nuk duhet të merret si relevante për vendimmarrje lidhur

me rastin, pasi që shpërndarja e sms-ve është bërë pa autorizimin e kandidatit në fjalë apo të LDK-së”.

Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit

36.1 Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;

b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli gjen se fushata përmes dërgimit të SMS-ve nga telefoni i dorës, në kundërshtim me nenin 36.1 të sipërpërmendur i referohet pikës nën (b) të kësaj dispozite juridike.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e bazuar.

Duke u mbështetur në nenin 116.2 të LZP-së ku thuhet se “*kërkohet nga të gjitha autoritetet kosovare ti ofrojnë ndihmën e nevojshme PZAP-it gjatë periudhës zgjedhore*” PZAP-i me datën 25.01.2011 me shkresën me nr 104/3 ka kërkuar nga

Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) që të bëjë verifikimin se kush është shfrytëzues i numrit 044 690 885. Në përgjigjen e ofruar nga PTK-ja të datës 25.01.2011 me nr. ZKL-091/11, lënda – identifikimi i abonentit - është vërtetuar se shfrytëzues i numrit 044 690 885 është Xhafer Tahiri, njëherësh kandidat për deputet i subjektit politik LDK për Kuvendin e Kosovës.

Si rezultat, nga shkresat e lëndës shihet se kandidati nga radhët e subjekti politik LDK ka thyer heshtjen zgjedhore, e që është në kundërshtim me nenin 36.1 pika (b) të LZP-së, prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 120.1 pika (c) të LZP-ës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 104/2011 më datën 26.01.2011

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

